

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kërcënoi kushëririn për 300 mijë euro, arrestohet 56-vjeçari në Vorë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/kercenoi-kusheririn-per-300-mije-euro-arrestohet-56-vjecari-ne-vore/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:59:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 14:03:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e616b93de6bfc88ef3226e57c4a18b640bf6123375f89f325d28b2d6a377b4f
TEKSTI	53bc038369b73ee7e47d65ea6d71fae54b0847e7a9dc95c647e1925088e07c7a
PAMJA	3371adb1edca3622f23f6d093e068652d139ab00885ce04f5f863fc1fe502537

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab89cc41cf8790750dde59aa48e215c20c70edf487ced2abaf9751958c1b7dc8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab89cc41cf8790750dde59aa48e215c20c70edf487ced2abaf9751958c1b7dc8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Kërcënoi kushëririn për 300 mijë euro, arrestohet 56-vjeçari në Vorë

AKTUALITET

Demo

Kërcënoi kushëririn për 300 mijë euro, arrestohet 56-vjeçari në Vorë

SEPTEMBER 13, 2026



Një 56-vjeçar është arrestuar në Vorë, pasi dyshohet se ka kërcënuar me jetë kushëririn e tij dhe familjarët e këtij të fundit, me qëllim për t'i marrë shumën prej 300 mijë eurosh.

Ngjarja u zbulua pas kallëzimit të bërë nga i afërmi i tij, i cili në portën e banesës, në fshatin Gërdec, ka gjetur një fishek dhe një letër me përmbajtje kërcënuese.

Në mesazhin e lënë pranë banesës kërkohej shuma prej 300 mijë eurosh, ndërsa në të kundërt kërcënohej jeta e tij dhe e familjarëve.

Pas kallëzimit, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 7 në Vorë nisën hetimet për identifikimin e autorit. Hetimet çuan në arrestimin në flagrancë të 56-vjeçarit Ardian Muka.

Gjatë kontrollit në banesën e tij, policia ka gjetur dhe sekuestruar municion luftarak, veshje që dyshohet se janë përdorur gjatë kryerjes së ngjarjes, si dhe një aparat celular.

Në përfundim të veprimeve hetimore, materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë për veprat penale "Shtrengimi me anë të kanosjes për dhënien e pasurisë" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, shpërthyes dhe municionit".

Hetimet vijojnë për dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

gjëja kushërinjte policia Vore

SHARE.



Postimet e reja

Zjarri në Valare të Gjirokastrës, flakët...

SEPTEMBER 13, 2026

Rama reagon ndaj gjyqtarit të GJKKO: E...

SEPTEMBER 13, 2026

Droni rus godet trenin në Ukrainë, pak minuta më...

SEPTEMBER 13, 2026

Trump paralajmëron Zelenskyn: Ndaloni sulm...

SEPTEMBER 13, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 8, 2026

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bërë thirrje për konsumatorët që kanë blerë një produkt sallami...

6 milionë euro të Startup Albania: Përfutuesit, qokat dhe "problematikët"

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje

LISTAT E DELINËS/ Granti për startup-et riciklon fituesit, 15 emra morën para edhe në vitin 2025

Na ndiq

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.